

**PERMBLEDHJE E MATERIALIT PER LEJE MJEDISORE TIPI B PER
AKTIVITETIN:**

**ID 3.1 e “ PERZIERJA E ÇIMENTOS OSE PERDORIMI I ÇIMENTOS NE MASE TE
MADHE POR JO NE SHESHIN E NDERTIMIT, PERFSHIRE AMBALAZHIMIN DHE
PERZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE PRODHIMI I
BLLOQEVE TE BETONIT DHE PRODUKTEVE TE TJERA TE ÇIMENTOS
(IMPIANT PRODHIM BETONI)**

**ID 3.10. PRODHIM I PRODUKTEVE ABRAZIVE DHE PRODUKTEVE TE TJERA
MINERALE JO METALIKE (PRODHIM INERTESH)**

SUBJEKTI “EURO - INERT 07” SH.P.K

**ELBASAN, NJESIA ADMINISTRATIVE GOSTIME, FSHATI PAZHOK, RRUGA
GOSTIME-GJYRALE**

**ADMINISTRATORE
MERITA SHERMADH**



1. HYRJE
2. BAZA LIGJORE
3. QELLIMI I VEPRIMTARISE
4. PERSHKRIMI I VENDODHJES
5. PERSHKRIMI I TEKNOLLOJISE
6. INFORMACIONE MBI CILESINE E AJRIT
7. INFORMACION MBI SHKARKIMET NE MJEDIS, IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE
NE MJEDIS TE AKTIVITETIT MASAT KRYESORE LEHTESUESE
8. PROGRAMI MENAXHIMIT
9. PROGRAMI MONITORIMIT

Hyrje

Rajoni i Shqipërisë Qendrore ku bën pjesë dhe zona e Gostimes, e zgjedhur për ngritjen dhe funksionimin e linjes për prodhimin e betonit dhe elementeve prej betonit si dhe linjes së prodhimit të materialeve inerte dhe infrastrukture mbështetëse të sajë nga subjekti "EURO-INERT 07" sh.p.k. është ndër hapësirat e rëndësishme dhe më të vlefshme të vendit, e parë nga ky kënd vështrimi, nga ai i zhvillimit ekonomik dhe vlerave mjedisore që ajo paraqet.

Në zhvillimin ekonomik-shoqëror të një vendi, gjithnjë në përputhje me parimet universale të zhvillimit të qendrueshëm, marrin një rëndësi të vecantë gjetja e rrugëve dhe teknologjive më efikase, si për shfrytëzimin sa më rracional të pasurive natyrore, ashtu dhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit në mjedis.

Gjatë dekadave të fundit veprimtari të ndryshme kanë ndikuar dukshëm në mjedisin rrethues në përgjithësi. Ndryshimet e sistemit të zhvillimit ekonomik të vendit duke u orientuar drejt ekonomisë së tregut ka bërë që konsumatori të kërkojë me shumë cilësi produkti dhe kulture shërbimi.

Vendi ynë është antare i një numri konventash ndërkombëtare si rrjedhojë është i detyruar të zbatojë një sistem sa më efektiv në fushat ekonomike -sociale-mjedisore dhe për rregullimin e territorit, sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore. Mjedisin është burim i gjithçkaje për të cilën njerezit kanë nevojë për të jetuar dhe për të zhvilluar. Sa më i degraduar të jete mjedisin aq më keq ndikon në shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik -social. Prandaj duhet një menaxhim sa më i mirë i mjedisit natyror në lidhje me aktivitetin njerëzor që po zhvillohet çdo ditë e më shumë. Në Shqipëri, zhvillimi i veprimtarisë ekonomike dhe tranzicioni i vështirë drejt ekonomisë së tregut ka ushtruar trusni të forta në mjedis duke ndikuar negativisht në të. Investimet e reja kanë sjelle ndikime në mjedis, por tashmë është arritur që shumë prej veprimtarive që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis përpara miratimit dhe zbatimit të tyre si qëllim për të parandaluar krijimin e zonave të tjera të ndotura. Ky qëllim është kaq i rëndësishëm sa që theksojmë që parandalimi është edhe më i mirë edhe më pak i kushtueshëm se sa kurimi.

Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e projektit.

Eksperti mjedisore është mbështetur në bazën ligjore të listuar më poshtë në zgjedhjen e teknologjisë dhe instalimin e saj. Subjekti zotohet të zbatojë me korrektesë të gjithë këto baza ligjore, V.K.M., rregullore të ndryshme si dhe të adoptojë aktivitetin e saj me bazën ligjore të re nëse behen ndryshime. Ligjet baze janë:

- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit";
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve";
- Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001, "Te mbrojtjes ndaj zjarrit";
- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2002, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta";
- Ligji Nr. 9108, datë 17.07.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike";
- Ligji Nr 8770 datë 19.04.2001 "Për shërbiminë ruajtës dhe sigurisë fizike";
- Ligji Nr 8756 datë 26.03.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri";
- Ligji Nr.9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore";
- Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor";

- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”;
- V.K.M.Nr.419, date 25.06.2014” Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisore te tipeve A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt tek tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kopetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”;
- *V.K.M. Nr.417*, date 25.06.2014 ”Per miratimin e tarifave te lejeve te mjedisit”;
- V.K.M. Nr.435, date 12.09.2002, “Per Normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”;
- V.K.M. Nr.1189, date 18.1.2009, ”Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit”;
- V.K.M. Nr.177, date 31.03.2005, “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese”;
- V.K.M.Nr.765, datë 7.11.2012”Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”;
- V.K.M. Nr.99, datë 18.02.2005 i Këshillit të Ministrave, “ Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve ”;
- V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010, ”Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane dhe turistike”;
- V.K.M.Nr.13, date 14.01.2013 ”Per miratimin e rregullave, afateve dhe pergjegjsive per informimin dhe pjesmarjen e publikut gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis”;
- Udhezimi Nr.8, date 27.11.2007, ”Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara.
- Udhezimi Nr.429, date 17.11.2009, i Ministrisë te Mjedisit, “Per rregullat dhe procedurat per paisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit”;
- Udhezimi Nr.6527 date 24/12/2004 “Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mynyrat e kontrollit te tyre“;
- Rregulloren Nr.1, date 15.03.2006, “Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive ndertimore“;
- Rregullore Nr. 1, date 30.03.2007, „Per trajtimet e mbetjeve te ndertimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjesimi i tyre“.

Projekti zbatohet gjithashtu edhe ne perputhje me ligjet dhe aktet nenligjore per urbanistiken dhe organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Qellimi i veprimtarise

Projekti i propozuar per tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B ka si qellim funksionimin e linjes se prodhimit te materialeve inerte, prodhimin e betonit dhe elementeve prej betonit nga keto lende te para nga subjekti “EURO - INERT 07 ”sh.p.k. Per nje funksionim sa me optimal dhe me cilesi qe synohen te ofrohen, jane ndertuar objektet dhe infrastruktura e cila do mbeshetese aktivitetin e mesiperm. Kjo veprimtari , zhvillohet prej vitesh dhe kemi mjetet e nevojshme teknike dhe nje staf te caktuar posaçerisht per kete veprimtari , dhe kemi si synim ruajtjen e shtreterve te lumenje sipas ligjeve, akteve ligjore dhe nenligjore, urdheresave dhe udhezimeve per kete synim, mbajtjen paster te rrugeve dhe shesheve perberese te tij , mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te njeriut si dhe

mbrojtja e mjedisit ne zbatim te ligjeve te dala ne vite per te minimizuar ndotjet. Ky raport paraprak eshte hartuar per te identifikuar ndikimet negative ne mjedis te kesaj veprimtarie dhe propozimet per masat zbutese te tyre. Duhet thene se specialistet kane pasur per baze Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, "Per Lejet e Mjedisit", neni 20 "Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B" si dhe Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe aktet e tjera normative qe lidhen me te";

Ne shfrytezimin e linjes se prodhimit te inerteve dhe te prodhimit te elementeve prej betoni nga subjekti "EURO - INERTE 07 "sh.p.k., do te merren te gjitha masat per zbatimin me perpikmeri te projektit te hartuar qe ai te siguroje nje zhvillim normal te procesit te prodhimit pa demtuar mjedisin.

Aktiviteti i subjektit te siperpermendur eshte ndermerre si nje inisiativë qe do te tentoje pervec rritjes se fitimit te investitorit edhe ne :

- Shfrytezimin dhe perdorimin e lendes se pare ne vend;
- Rritjen e punesimeve ne zonen perreth;
- Permiresimin e sistemit te ndertimit dhe infrastruktures rrugore ne nivele lokale.

Pershkrimi i vendodhjes se veprimtarise shoqeruar me harten ilustruese dhe fotografi nga objekti.

Veprimtaria ushtrohet ne rrethin Elbasan , Njesisa administrative Gostime, Fshati Pazhok, Rruga Gostime-Gjyrale, Zona Kadastrale 1820, Nr.pasurise 879/3 dhe 879/2 .

Pershkrimi i veprave inxhinjrike dhe veprave te domosdoshme per zbatimin e projektit.

Ne hapesiren e territorit ku do te zhvillohet veprimtaria eshte instaluar teknologjia qe sherben per ushtrimin e veprimtarise si dhe eshte ndertuar infrastruktura e sherbimeve mbeshtetese te operacioneve. Nder njesite dhe veprat kryesore te projektit jane:

- Sheshi depozitimit te materialit-bunkeri gurit dhe zhavorit ;
- Linja e prodhimit te larjes se inerteve te lumit se bashku me shoshat vibruese(kur perdoret lende e pare inertet lumore)
- Gurethyes
- Linja e prodhimit te betonit ;
- Dekantuesi i reres
- Depo rere e lare, depo rere e thyer
- Sheshi Parkimi i automjeteve;
- Sillozat e çimentos
- Depozite uji
- Zyra e kantjerit ;
- Kabine elektrike
- Lavazh 120m².
- Ambjente sherbimi 65(zyra 50)m².

Krahas tyre eshte ndertuar

- 1.Sistemi i kanalizimeve dhe parandalimit te ndotjes se mjedisit, puseta dhe kanale mbledhes te ujrave.

2. Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, fikse zjarri portative, kosha metalike, tabela sinjalizuese, rezervuar uji i lidhur me nje pompe qe siguron uje me presjon ne te gjithë ambjentet e punes.
3. Sistemi i rrjetit elektrik, telefonik dhe atij hidrik per ushtrimin e veprimtarise.
4. Sistemi rrugor.

Pershkrimi i proceseve teknologjike.

Impianti i prodhimit te inerteve prej guri dhe betonit

Teknologjia e prodhimit te inerteve dhe e elementeve prej betoni eshte teknologji e thjeshte e standarteve europiane.

Produkte te ketij impianti do te jete prodhimi i inerteve prej rere dhe guri me dimensionete ndryshme si dhe prodhimi i elementeve prej betoni sipas kerkesave te tregut. Linja e prodhimit ka nje kapacitet prodhues variabel 40- 60m³ beton/ore dhe punon me cikël te mbyllur. Produkti i ketij impianti do te furnizoje industrine e ndertimit ne zone e me gjere.

Ne baze te fraksioneve inerte te perdorura, raporteve midis tyre dhe aditiveve te lidhjes se granulave (çimento) ne impianti do te prodhohet beton dhe elemente prej beton(tuba me dimensione te ndryshme, elemente trotuaresh(bordura), pllaka betoni etj.

Lendet e para.


Lenda e pare qe perdoret per prodhimin e inerteve eshte materiali inert lumor qe eshte gjendje si dhe inertet gurore qe merren nga subjekte te licensuara.

Pershkrimi dhe Volumet e Punimeve Punimet konsistojne ne transportim, depozitim dhe perpunim te inerteve per prodhimin e materialeve te ndertimit prej betoni. Punimet e instalimit konsistojne ne transportimin e paisjeve si sillosa, elektromotorra, elektropompa, transportier, mulliri prerjes se gurit, profile te ndarjes se vend-depozitimit e inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Kjo linje teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga keto njesi baze:

Bunkeri i depozitimit te materialeve inerteve qe vijne nga karrierat .

Bunkeri eshte edhe stacioni i pare i materialit inert i cili i nenshtrohet nje numri te caktuar procesesh. Materiali inert qe depozitohet ketu do te jete gjithmone ne gjendje te lagur pasi do te sperkatet me uje per efekt te eliminimit te çlirimit te pluhurave gjate procesit te thyerjes se tije. Bunkeri i depozitimit ka formen e nje hinke me fund nga siper, nje kapacitet volumetrik relativ prej 20 m³ , i ndertuar prej metali çeliku me diameter flete prej 0.8 mm bunkeri eshte teper rezistent ndaj forcave mekanike. Ne bunker shkarkohet materiali inerte i cili nepermjet forces terheqese gravitacionale drejtohet ne sistemin e bluarjes ose coptimit si dhe ne sistemin e sitosjes. Kalimi i materialit behet nepermjet transportjereve, dhe ndarja e tij behet ne sita perkatese .




Skema teknollogjike

A. Kabine Elektrike

1. Transportiere L=20 metra
2. Transportier L=20 metra
3. Transportiere L=20 metra
4. Transportier L=20 metra
5. Transportier L=16 metra
6. Transportier L=12 metra
7. Larese (ne se do te perdoret rere lumi) $S=15 \text{ m}^2$
8. Site me dy kate $S=10 \text{ m}^2$
9. Transportier L=21 metra
10. Fronto
11. Site me dy kate $S=2 \text{ m}^2$
12. Pompe uji $Q=4 \text{ m}^3/\text{min}$
13. Transportier L=21 metra
14. Site me dy kate $S=6 \text{ m}^2$
15. Transportier L= 20 metra
16. Transportier L=16 metra
17. Transportier L=20 metra

18. Site me dy kate $S=6 \text{ m}^2$
19. Transportier $L=21$ metra
20. Transportier $L=10$ metra
21. Mulli 60×40 cm
22. Mulli 40×40 cm
23. transportier $L=23$ metra
24. Bunker dozatore 20 m^3
- A. Pult komandimi 5×3 metra
- B. Kabine elektrike 7×3 metra

Pjesa mbi site qe perbehet nga material i trashe, nepermjet transportierit (23) kalohet ne procesin e grimtesimit ne mullinj.



Proçesi i therrmimit se materialit ne mullinj (21)(22)

Treguesit fiziko – mekanik dhe kimik te lendes se pare

Lendet e para.

Lenda e pare qe perdoret per prodhim te materialeve inerte per ndertim jane kryesisht materiale inerte qe merren nga lumi qe perfaqesojne materiale me konsistence zhavori apo rere si dhe inerte gurore qe merren nga subjekte te licensuara .

Permbajtia Mineralogjik e Agregatit

Klasat	+2.5mm (0.2%)	+1,25 mm (0.3%)	0.63 mm (15%)	+0.32 mm (60%)	+0.15mm (25,5%)
Copa karbonate	-	-		35%	36%

Copa Ranore	30%		22%	20%	15%
Gelqerore	25%	28%	32%		
Kalcit	3%	-	5%	5%	10%
Kuare i paster	10%	12%	12%	15%	18%
Copa dru/qymyr	2 %	-			
Agregat shkemb.	30%	-	28%	20%	20%
Agreg.magmatik	-	30%			
Agreg.ranor	-	30%			
Mika	-	-	Deri 1%		Deri 1%

Lenda e pare qe do te perdoret per prodhim betoni do te jene inertet e perpunuara nga impianti dhe nga analizat e bere rezultojne keta tregues: Ne aspektin litologjik perberja e inerteve eshte :

Gelqeror 45%

Ranor 40%

Magmatik 10%

Shkembej te tjere 5%

Vetite fiziko-mekanike te tij jane:

Masa vellimore 2.483gr/cm³

Masa specifike 2,58 gr/cm³

Rezistenca ne shtypje 700-1200kg/cm²

Poroziteti 0,9%

Koeficjenti zbutjes 0,27

Perberja granulometrike e materialit qe do te shfrytezohet sipas analizave laboratorike eshte si me poshte:

Inerte me permasa mbi 20-30 mm 23.7%

Inerte me permasa 0-5 mm 30.3%

Inerte me permasa 5-10mm 25 %

Inerte me permasa 10-20mm 21 %

Përshkrimi i procesit teknologjik te punes.

Materialet inerte qe do te perdoren per prodhimin e betonit sipas klasave te ndryshme do te jene te cilesise se larte dhe konform kushteve te ciesise per keto produkte. Inerti qe do te perdoret eshte paraprakisht i pastert . Linja e prodhimit te betonit dhe elementeve prej betoni perbehet nga sheshi i depozitimit te ruajtjes se fraksioneve te granilit dhe reres magazine e depozitimit te çimentos. Prodhimet prej betoni prodhohen sipas kushteve teknike teknologjike dhe realizohen ne funksion te kerkesave te subjekteve juridike dhe fizike te bazuara ne projektet e preventivat e hartuara.

Betoni eshte material qe nuk gjendet ne natyre ne menyre te drejtperdrejt por krijohet me perzierjen e komponenteve perberese : çimentoja , agregateti (rere, zall) , uji dhe ne te shumten e

rasteve edhe aditive, shtesave mineralogjike etj. Çimentoja si lende lidhese pas veprimet me ujin krijon nje strukture se bashku me agregatin qe me kohën ngurtesohet. Agregati paraqitet si mbushes qe ze pjesen me te madhe ne masen e betonit. Uji zakonisht perdoret me $ph=7$. Aditivet si komponente mund te themi se jane te domosdoshme sa i perket prodhimit te betonit dhe ate qe te permbushin kushtet e betonit te parashtruara me kerkesa te caktuara (psh i papershkueshem ndaj ujit, qendrueshem ndaj ngrirjes/shkrirjes etj). Shtesat mineralogjike si komponente perdoren kur deshirojme qe te arrijme rezultate te larta ne nejt drejtim, ndersa ne anen tjetër mos te shkaktohen rezultate te uleta ne drejtimet tjera (psh te rritet soliditeti ne shtypje duke mos rritur shume sasine e çimentos). Betoni si material ka aftesi qe ne gjendje te njome te marre forma te çfaredoshme dhe ate forme ta mbaje pas ngurtesimit me nje aftesi te konsideruar mbajtese. Prodhimi i elementeve prej betoni sipas kerkesave te caktuara kerkon percaktimin e sakte te sasise se materialeve perberes te tij. Ne percaktimin e sasise se çimentos duhet te kihet kujdes qe te merren ne konsiderate keto elemente: - Betoni qe do te perdoret - Dimensionet e elementit apo konstruksionit - Nxehtesia e hidracionit ne beton - Aspekti i ekspozimit te konstruksionit Meqenese agregati si komponente i betonit eshte me i lire ne krahasim me çimenton atehere edhe perdorimi i tij eshte ne sasi me te madhe ne prodhimin e betonit. Po ashtu ndikimi i agregatit eshte i konsiderueshem ne stabilitetin vellimor dhe jetegjatesine e betonit. Ne varesi te kerkeses per llojin e caktuar te betonit , me veti te caktuara behet edhe percaktimi i sasise se aditiveve. Betoni i njome eshte perzierje e ujit, çimentos, agregatit, aditiveve dhe eventualisht shtesave mineralogjike. Pas perzierjes se komponenteve perberese qellimi eshte prodhimi i nje mase uniforme, te pershtatshme per prodhim elementesh prej betoni ose per transport , hedhje ne veper, ngjeshje dhe rrafshim te siperfaqeve kur eshte ne gjendje te njome. Vetite me te rendesishme te betonit te njome jane:

- 1- Perpunueshmeria (konsistenca) e betonit te njome Ne menyre praktike perpunueshmeria qendron ne lehtesine e hedhjes se betonit derisa te marr formen perfundimtare. Konsistenca e betonit paraqet shkallen e plasticitetit te betonit dhe nderlidhet me aftesine e betonit te njome qe hidhet ne veper dhe mundeson nje ngjeshmeri te mire.
- 2- Masa vellimore e betonit te njome
- 3- Sasia e ajrit (poreve) ne beton

Proçesi i prodhimit te betonit Linja e prodhimit te betonit, eshte nje teknologji e parametrave bashkohore ne te cilin cikli i prodhimit eshte i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me elementet e mjedisit. Impianti i prodhimit te betonit perbehet nga keto njesi teknologjike funksionale si me poshte.

Bunkeret e depozitimit te materialit inert te fraksionuar sipas granulometrise te pershkruar me siper per tre fraksionet rere dhe granil 1 dhe 2. Fraksionet qe depozitohen aty jane ne gjendje te lagur dhe vijne direkt nga sillozet e impiantit te fraksionimit te inerteve. Bunkeret jane ne forme hinke te rezistueshem nga goditjet.

Peshoret e dozimit te fraksioneve, keto njesi matese peshuese jane montuar ne fundin e çdo bunkeri dhe ne to matet dhe percaktohen ne mynyre automatike raportet e secilit fraksion sipas qellimeve te prodhimit per llojin e betonit. Ky proçes eshte i drejtuar nga njesia e kontrollit kumpiuterike e impiantit.

Shtrati i pritjes dhe trasmetimit te mases se fraksioneve qe eshte nje rryp trasmissioni horizontal me gjeresi 80 cm. Ky rryp trasmissioni e drejton dhe shkarkon materialin ne nje trasmetues tjetër me kend 40 grade edhe ky perbehet nga nje rryp trasmissioni me gjeresi 60 cm qe e percjell materialin inert ne perzjerës.

Bunkeri i çimentos, është një hinke metalike i cili është montuar mbi perzjersin. Ketu mbahet e teresisht e izoluar sasia e çimentos që perzihet me materialin inert. Në fundin e këtij bunkeri gjendet një peshore që realizon dozimin përkatës të çimentos.

Perzjerësi i masave është agregati i fundit i impiantit që realizon perzjerjen e materialit inert dhe çimentos. Në pjesën e sipërme të tij janë montuar një sistem sitash vibruese homogjenizuese të fraksioneve që ndihmon në procesin e perzjerjes. Sasia e duhur e çimentos leshohet në perzjerës nepermjet një hinke të posaçme gjithashtu në perzjerës është montuar dhe një sistem tubacioni që i shton masës ujë të nevojshëm për lidhjen e masave. Uji që përdoret për prodhimin e betonit merret nga puset të cilat janë vite që janë hapur dhe shfrytëzohen dhe dozohet nga një aparat i posaçëm dhe i kontrolluar nga kompiuteri. Ketu mbyllet procesi i prodhimit të betonit dhe me pas ai ngarkohet në auto –betoniere. Procesi i prodhimit të betonit është teresisht një cikël i mbyllur dhe izoluar me ndikim fare minimale dhe të pakonsiderueshme në mjedis.

Njesia e komandimit të procesit është një kabine metalike 2x2m ku gjendet një kompiuter i cili komandon procesin teknologjik të prodhimit të betonit.

Me pashte po rendisim disa analiza përfaqësuese të betoneve të realizuara

Procesi i punës i elementeve prej betoni konsiston si më poshtë:

Impianti funksionon në këto mënyra: në bunkerin e furnizimit të inerteve hidhen me kamion inerte të fraksioneve të ndryshme sipas cilesise se kerkuar te produktit. Me pas nepermjet transportierëve ato transportohen për në mikserin e perzjerjes se materialit. Me pas perzihen me çimenton dhe llaçi i gatshëm i transmetohet makinerise e cila preson blloqet me llaç gjysem të thatë, duke prodhuar blloqet, pllakat e betonit, bordurat dhe elemente të tjera prej betoni. Materiali ngarkohet në mjetet e rënda të transportit nepermjet vinçit, nga kamione vetngarkues-vetshkarkues. Procesi kryhet me çimento pluhur jo të lengshme, e cila blihet e gatshme, shtohet ujë dhe me pas perzihet në mikser e shkarkohet në autobetonieret e transportit. Raportet çimento, inerte, ujë janë sipas cilesise se kerkuar te betonit.



PRODHIMI I SHTYLLËS SË BETONIT

A) Masat paraprake: .

Kontrolli i pajisjeve të punës : Para fillimit të punës, punonjësi kontrollon pajisjet e punës (formën e poshtme , formën e sipërme, atrecaturat e shtrëngimit, çelësat shtrëngues, makineritë centrifugën etj) të cilat duhet të jenë në gatishmëri të plote teknike, të pastra dhe të kolauduara. Vishen mjetet mbrojtëse (doreza, çizme, përparëse, etj).

Përgatitja e formës për derdhje : Sipas llojit të produktit që do të prodhohet përgatiten format për derdhje dhe materialet ndihmëse. Kontrollohen format për pastrim dhe bëhet sprucimi i vajit të armimit në të dy pjesët e formës. Kontrollohen bulonat shtrëngues dhe plotësohen në rast se mungojnë. Pasi forma konsiderohet gati vazhdon hapi i kompletimit të saj me elementët e perkates. Kujdes ! Në asnjë rast nuk duhet të filloj puna pa kontrolluar formën për pastërti dhe pa e kompletuar me atrecaturat mbyllëse.

B) **Zbatimi i procesit te prodhimit:** Duke ndjekur radhën e shtimit te elementëve përbërës të shtyllës së betonit ndiqen etapat :

Faza e pare a) Vendoset përforcuesi me tel çeliku që do të shërbejë si zgarë për lidhjen e betonit. Zgara metalike përbëhet nga tre pjesë 1. Fijet e çelikut përforcues që realizohen me tel çeliku me dimension nga $\varnothing=6\text{mm}$ deri $\varnothing 16 \text{ mm}$, (sipas llojit të shtyllës), 2- Fija spirale që mbështjell përforcuesin e çelikut dhe që është me tel çeliku me dimensione të njëjta me përforcuesin, 3- unazat e çelikut (stafat) që lidhin fijet e çelikut të përforcuesit dhe që përgatiten me fije çeliku me dimension $\varnothing=4 \text{ mm}$. Gjatë vendosjes së përforcuesit metalik në formë duhet të pozicionohen mirë spesoruesit e hapësirës së betonit midis formës dhe përforcuesit metalik. Pozicionohet mirë përforcuesi metalik pa dëmtime dhe deformime. Pozicionimi realizohet në pjesën e formës së poshtme.

Faza e dyte b) Pasi përforcuesi metalik është pozicionuar mirë afrohet kova e betonit të përgatitur dhe kryhet derdhja e tij në formën e poshtme. Duhet të kihet kujdes që gjatë derdhjes së betonit, ai të shpërndahet uniformisht në të gjithë formën. Pasi është derdhur e gjithë sasia e betonit të kalkuluar në pjesën e formës së poshtme fillon vendosja e formës së sipërme dhe shtrëngimi i saj. Shtrëngimi duhet të kryhet sa më mirë dhe brenda rregullave teknike në mënyrë që të mos të lihen hapësira midis nollave të formave për rrjedhjen e betonit gjatë procesit të centrifugimit.

Faza e trete c) Forma e mbushur dhe e mbyllur ngrihet me kujdes me vinç dhe vendoset në centrifugë për të realizuar formimin e shtyllës. Rrotullimi i formës me beton fillon gradualisht deri sa centrifuga të marri parametrat e centrifugimit të cilat janë 400 xhiro /min dhe vazhdon me këto parametra deri në 20 minuta. Gjatë kësaj kohe duhet të kontrollohet më kujdes hapësira e brendshme shtyllës dhe shpërndarja e materialit në të gjithë formën në mënyrë uniforme. Pasi verifikohet (pas 20 min) që sipërfaqja e brendshme e shtyllës është në rregull dhe uniformisht e realizuar ngrihet forma me vinç me kujdes dhe dërgohet në sektorin e trajtimit për tharje. Pasi qëndron 24 orë në tharje natyrale fillon faza e tharjes me avull të ngopur.

Kontrolli i shtyllës së betonit dhe shënimi i numrit të LOTit për identifikimin e saj. Shtylla e betonit është mirë që përpara se të magazinohet duhet të inspektohet për defekte të mundshme që mund të kenë ndodhur gjatë centrifugimit. Sipas shkallës së defektit mund të kemi dy tipe seleksionimi 1- defekte të riparueshme dhe 2- defekte të pa riparueshme (skarcitet) . Shtyllat me defekte të pa riparueshme duhet të eliminohen dhe të spostohen nga sektori i prodhimit. Shtyllat e konsideruara brenda Standardit (dhe të riparuarat) identifikohen me nje numër LOT i cili të përmbledhi numrin e centrifugës ku është prodhuar dhe numrin e shtyllës në rradhën e prodhimit. Ai shkryhet me marker ose me bojë me prajt në trupin e shtyllës. Ky numër do të ndihmojë në te ardhmen kompaninë për të realizuar gjurmueshmërimë në rast të reklamimeve të mundshme nga klientët. Numëri i LOT-it i jepet magazinës në fletën e hyrjes së produktit në magazinën e produktit të gatshëm dhe Laboratorit për të vlerësuar markën e betonit të analizuar me numrin e shtyllave të realizuar gjatë ditës.

Lendet e para per perkatitjen e betonit dhe produktet perfundimtare

a-Perbersit e betonit marka 300

I-Çimento Portland 42.5R

-Densiteti: 3.0gr/cm³

-Koha e ngrirjes Fillimi 110 minuta Mbarimi 160 minuta

-Rezistenca 28 ditore 55.0 Mpa

- 2- Rere natyrale 0-3 mm
- Pesha specifike 2.685 g/cm³
- Moduli i imtesise 3.1
- Pesha vellimore 1462
- 3- Rere betoni 3-5 mm
- Pesha specifike 2.690 g/cm³
- Moduli i imtesise 86
- Masa vellimore 463 kg/m³
- 4- Granil "1" (5-10) mm
- Pesha specifike 2.695gr/cm³
- Moduli i imtesise 5.9
- Masa vellimore 15463 kg/m³
- 5- Granil"2" (10-20) mm
- Pesha specifike 2.697gr/cm³
- Moduli i imtesise 7.29
- Masa vellimore 1506 kg/cm³
- Per marken e betonit 300 p**
- 1- Çimento 400kg/m³
- 2- Aditiv 2. 125litra
- 3- Inerte 1862.5kg
- 4- Uji 143.7 litra
- 5- Lageshtia 6,50%
- 6- Pesha vellimore 2408kg/m³
- 7- Konsistenca 11.5cm
- 8- Raporti uji/cimento 0.373

Ne lidhje me ngarkimin dhe transportin eshte parashikuar qe pajisjet do te perbehen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj. Kjo zgjidhje behet per shkak te adaptueshmerise dhe fleksibilitetit te larte qe kane keto lloj pajisje, shkalles se larte te disponueshmerise, si dhe mundesine per ti kombinuar ato per te realizuar punime te ndryshme sipas nevojave te prodhimit. Nevojat per ngarkim percaktohen nga numri i kamionve te nevojshem qe varen nga distanca e transportimit, disponueshmeria per pune e makinave ngarkuese dhe e kamioneve, oret e punes ne dispozicion per dite/turn, etj.

Pershkrimi dhe Volumet e Punimeve.

Punimet konsistojne ne transportimin, depozitimin dhe perpunimin e materialeve inerte per prodhim e elementeve prej betoni. Punimet e instalimit konsistojne ne transportimin e paisjeve si silllosa, elektromotorra, elektropompa, transportier, profile te ndarjes se vend-depozitimitt e inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Skema teknologjike e prodhimit te betonit

4.1 Programi i punes

Per zhvillimin e projektit eshte kaluar ne disa faza - Fillimisht eshte vendosur zona ne te cilet do ndertohet linja e prodhimit - Ndarja e sheshit ne zona perkatesisht per zonen ku do te depozitohen lendet e para, parkimi i automjeteve etj - Faza e fundit ka te bej me sistemimin e linjes per zhvillimin e prodhimit te betonit

4.2 Plani i instalimit te linjes dhe afati zbatimit te tij

Fazat qe jane planifikuar per instalimin e linjes se prodhimit te betonit jane:

4.3 Furnizimin me uje. Kryesisht deri tani eshte marre uje nga lumi Devoll dhe liqeni , dhe per kete nga ana jone disponohen pagesta perkatese prane AUB-se. Zona ka infrastrukturen te ngritur persa i perket furnizimit me uje te pijshem, sepse kjo zone ka shume vite qe funksionon si e tille. Nderhyrjet ne rrjete do te jene ne funksion te permiresimit te furnizimit me uje teknologjik.

4.4- Rrjeti i kanalizimeve te ujerave te zeza. Ne funksion te nevojave te objektit te sherbimit do te perdoret rrjeti ekzistues i kanalizimeve. Sistemi i evakuimit te ujerave te zeza per vete karakteristikat e kanalizimeve te zones do te jete nje sistem unitar. Perberja e ujrave te zeza nga destinacioni qe ka zona do te jene ujera komunale, te dala nga objekti. Normat e perdorimit te ujit per aktivitetin do te percaktohet nga destinacioni i perdorimit te ambjenteve te sherbimit, pas miratimit perfundimtar te projektit. Rakordimi altimetrik dhe planimetrik i rrjetit do te realizohet si zakonisht me puseta te pergatitura ne vend ose te parafabrikuara. Gjithashtu ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza do te vendosen puseta kontrolli ne distance 50m nga njera tjetra, ne largesi lineare te rrjetit. Evakuimi i ujrave atmosferike do te realizohet me ane te sistemit te kunetave dhe pusetave te vendosura ne anet e rrugeve duke i derguar ato drejte kolektoreve rrugore. Kolektimi i te gjitha ujrave te zones do te realizohet ne kolektoret kryesore.

4.5.Furnizimi me energji elektrike Per furnizimin me energji elektrike jane bere instalime te reja dhe eshte ndertuar kabine elektrike. Furnizimi me energji elektrike behet ne baze te kontrates qe eshte lidhur me sistemin shperndares.

4.6- Faza e funksionimit Ne kete impiant jane te perfshira magazina e cimentos , sheshet e materialeve te granilit te fraksionuar, rere guri. Proçesi i punes fillon me afrimin e materialeve prane vaskave me ane te eskavatorit me rrota. Betoniera afrohet prane transportierit levizes ku me aten e te cilit transportohet materiali sipas gramaturave te percaktuar per çdo marke betoni. Ne fund te transportierit levizes ndodhet nje hinke ku injektohet sasia e cimentos dhe e ujit njekohesisht. Hedhja e sasive te materialeve behet ne baze te llogaritjeve perkatese per marken e betonit. Perzierja e materialit behet ne betonierat.

Permbledhja tabelore vlerimit te ndikimeve ve mjedis

Nga çka trajtuam me sipër, me qellim konformimiteti me metodikat zyrtare te vleresimeve te ndikimeve ne mjedis por edhe per nje identifikim me racional te tyre, ne tabelen e meposhtme paraqiten te detajuara efektet negative, vendin ku dhe si ndikojne ato.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
Ne toke	Po	Jo
Humbje tokes per kullote		X
Ndryshime topografike te terrenit		X
Prishje punime bujqesore		X
Ndotje e tokes nga rrjedhjet		X
Ndotje e tokes nga mbetjet e ngurta		X
Ndotje e tokes nga depoz. llumrave	X	

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve
Ne ajer	Gjate shfrytezimit

	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit	X	
Ndotje nga djegia e hidrokarbureve		X
Ndotje nga CO,SO ₂ ,NO _x		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne floren dhe faunen	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Shkatërrim i rendesishem habitateve natyrore		X
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë në zonat e virgjera		X
Rrezikimi i nderhyrjes në bimët e ujit		X
Percarje/izolim habitanteve të egra		X
Interferenca midis rrugëve natyrore të emigrimit të sisoreve		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne uje	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Trajtimi i ujërave të ndotur	X	
Ndotja e ujit nga pluhuri, plumbi, derdhje aksidentale të substancave të tjera		X
Impak sekondare në ndotje të ujit për tokat bujqësore, ujërat tokësore etj.		X
Modifikimi në drenazhimin e ujërave natyrore		X
Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Nga zhurmat	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritja e nivelit egzistues të zhurmave	X	
Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinerive	X	
Rritja e nivelit të zhurmave për njëzërit		X
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Perfitimin e tokës	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Prishje banesash		X
Ndryshime të rendesishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës	X	
Ndotje nga CO,SO ₂ ,NO _x		X
Rivendosje banesash		X

Shpronime te tokave		X
---------------------	--	---

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne trashegimine kulturore	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Ndryshime apo demtime te zonave arkeologjike apo me vlera historike dhe kulturore		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne energji	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Perdorimi ne sasi te medha te karburantit per energji		X
Rritje te rendesishmete kerkesave per burime egzistuese te energjise apo kerkesave per tipe te tjera te energjise		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne interesin publik (infrastruktura)	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Zhvillimi i aktivitetit do te kete nevojte ne fushe te interesit publik	X	
Energji elektrike		X
Sistemim i komunikacionit		X
Sistemim i kanaleve te ujrave te zeza e te bardha		X
Sistemim te ujessjellesit		X
Mbetje te ngurta e sistemim te tyre	X	

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne shendetin e njerezve	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Krijimi i cfaredo rreziku apo mundesie per demtimin e shendetit te njerezve		X
Krijimi i raportit te njerezve me rreziqet e mundeshme per demtimin e shendetit te tyre		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne qarkullim e transport	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritje te rendesishme te qarkullimit e transportit te automjeteve		X

Pakesim te veteqendrimit te automjeteve apo nevojave per vend qendrim te reja		X
Ndikime te rendesishme ne sistemin e komuikacionit		X
Ndryshime ne qarkullim apo te levizjes se njerezve e mallrave		X

Ne kete table renditen nje sere kerkesash qe ndihmojne ne vleresimin e nderveprimeve ne mjedis si dhe gjykohet ne se veprimtaria do te kete ndikime potencjale/thelbesore ne elementet perberes te mjedisit.

Ndikimet tek njerezit, ndertesa dhe objektet e ndertuara nga njeriu .

Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazhi.

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet regjenerimi hap pas hapi i ambjenteve te punes. Ne vendet e caktuara ne projekt parashikohet depozitimi te materialeve inerte pa perdorim dhe perpunimi i tij me toka vegjetale per te mundesuar mbjelljen bimet e pemet dhe pemeve karakteristike te gjelberuar dhe me shlodhese per syrin.

Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportit.

Sot per sot objekti eshte i lidhur me rrugen nacioanele Gostime Elbasan, Gostime-Gramsh dhe Gostime-Belsh me nje rruge dytesore te pashtuar. Ky segment rruge mirembahet dhe do te mirembahet vazhdimisht. Intensiteti i levizjes se makinave te transportit te subjektit ne kete segment nuk do ta rendoje trafikun aktual, kjo per faktin se ne kete segment rrugor parashikohet te levizin pak makina transporti ne dite.

Mjetet e transportit qe jane te tonazhit deri 20ton ton do te sherbejne si mjete levizese per transportin e materialit.

Keto mjete do te jene te nje cilesie te larte dhe nuk do te perbejne asnje problem per komunitetin e kesaj zone (sepse eshte mjaft larg pothuajse 2km).

Ndikimet e projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi vepra te tjera njerezore

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone dhe perreth saj nuk ka asnje objekt te nje rendesie te veçante te karaktereve te lartpermendura.

Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitete duke perfshire ndikimet nderkombetar.

Sikunder eshte trajtuar edhe me lart, nga zbatimi ne praktike i projektit te copetimit dhe seleksjonimit te materialeve inerte, ne sipërfaqen e ushtruar, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet.

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

Konsekuenca te tjera ekologjike.

Ushtrimi i aktivitetit te ketij objekti nuk sjell pasoja te tjera ekologjike. Me hollësisht te dhenat konkrete per ndikimin e mundshem ne aspektin mjedisor jane dhene ne paragrafet e veçante, qe flasin per aspekte te veçanta te ndikimit mjedisor.

Ndikime te tjera klimaterike.

Gjate dhe pas ushtrimit te aktivitetit te shfrytezimit, nuk priten ndryshime klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Pra kryerje e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate proçesit te shfrytezimit.

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve te pajisjes se coptimit, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor , faun dhe flore.

Identifikimi i masave per te eleminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis.

Masat teknike.

Keto masa do te sherbejne si barriera per pluhurat qe mund te çlirohen gjate ushtrimit te aktivitetit gjate aktivitetit.

Uljen e intensitetit te perpunimit per stinen e veres si dhe lagia e terreneve nen pune dhe lagia e materialit qe do te perpunohet, do te evitohet edhe ndotjen gjate prodhimit dhe transportit.

Nderkohe sigurimi i karburanteve per djegie me cilesi te larte dhe me permbajtje te sqfurit te vogel do te realizoje nje prodhim pa shume shqetesime per ndotjen e ajrit nga shkarkimet e gazeve te djegjes.

Sistemi i mbrojtjes ngaj zjarrit - Sigurimi i jetes se puntoreve dhe investimit nga zjarri realizohet nepermjet nje sere pajisjesh dhe mjetesesh te cilat garantojne neutralizim te shpejte te çdo zjarri te shkaktuar na ambientetet e kantierit. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri mund te kategorizohet ne dy njesi funksionale paisjesh dhe instalimesh:

1 – Njesia qendrore e parandalimit dhe shtypjes se elementeve zjarr – venese nepermjet nje sistemi qendror komandues i cili mbeshtetet ne nje depozite uji dhe sistem tubash me presion. Ky sistem lejon shperndarjen e ujit me presion ne hidrante te vendosur ne çdo kend te subjektit.

2 – Njesia e mjeteve te nderhyrjes dhe neutralizimit te perhapjes se zjarrit (dy fikse zjarri e levizshme me shkume 25 l) te vendosura ne ambientet e jashtme te objekteve.

I gjithë personeli qe do te punesohet ne kete aktivitet do te trajnohet nga specialistet perkates te subjektit per menyren e veprimit ne rast aksidentesh, kordinimit te operacioneve dhe nderhyrjes efikase.

Plani i Menaxhimeve te Elementeve me Ndikim ne Njedis

Lidhur me Planin e Menaxhimit te ndikimit ne mjedis Shoqeria “EURO-INERT 07” sh.p.k, ka nje vizion te qarte, modern dhe realist ne realizimin e zbatimit te ketij plani, fale eksperiences qe ka subjekti me personelin e tij dhe konsultimeve te vazhdueshme me specialiste te ndryshem. Shoqeria e sheh zbatimin e Planit te Menaxhimit te elementeve me ndikim ne mjedis jo vetem si detyrim ligjor dhe moral por si nje pjese e pandare e suksesit te punes se saj ç’ka i jep nje shtyese edhe me te forte ne menaxhimin me sukses te elementeve me ndikim ne mjedis.

C'fare	Si
Parandalim	<ul style="list-style-type: none">- Perzgjedhja e teknologjise me cikël te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit- Materialit inert qe do te fraksionohet do te jete gjithmone i lagur dhe fraksionimi do behet ne prani te ujit- Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje se pajisjeve- Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave- Perdorimi i naftes D1 per kamionet dhe per kaldajen e impiantit te

	prodhimit te asfaltit - Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj - Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjitha teknologjise se projektit, sistemit te qarkullimit te produktit, etj - Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj deri ne nivel detali
Kontroll	- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash - Kompaktesim dhe lagie e inerteve ne qiell te hapur - Lagie e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier - Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij - Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes sidomos para se ma dale ne rrugen nacionale - Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulese me polietilieni
Nderhyrje	- Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara sipas skemes. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)
Administrim	- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjitha infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit e kantierit do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga llumrat qe dalin gjate procesit te larjes se lendes se pare si dhe nga dispersiteti i ambalazheve te ndryshme qe mund te kete etj. Llumrat e dala qe jane dhera depozitohen ne gropen e dekantimit dhe do te sherbejne per mbushje te tokave qe jane me probleme.

Ne mjediset e kantierit jane vendosur kazane te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet e grumbulluara do te transportohen ne menyre periodike ne vend-depozitimin e percaktuar nga pushteti lokal.

Manaxhimi i mbetjeve te lengta. Mbetjet e lengeta jane ujrat qe shkarkohen nga larjet teknologjike te skemes si dhe ato nga impianti i dekantimit dhe pastrimit me flotim te ujit qarkullues. Ujrat e shkarkuara jane brenda normave te lejuara dhe nuk permbajne elemente ose substanca ndotese sepse perdoren vetem per larjen e inerteve qe jane lende natyrore. Uji qe derdhet nga ky perpunim eshte i pastert dhe nuk shkakton ndotje te mjedisit. Shkarkimet e ujrave te kantierit largohen nga territori i tij pasi kalojne ne gropa dekantimi dhe nepermjet tubave nentokesore kalojne ne kolektorin kryesor.

Menaxhimi i mbetjeve te gazta- nuk ka me perjashtim te gazrave qe leshojne makinat e transportit

Programi i monitorimeve dhe elementet e tije.

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM-ne, ARM-ne, Bashkine etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne AKM dhe ARM-ne e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proçeduarve ligjore dhe rrgulloreve.

Nr	Natyra e monitorimit	Frekuenca	Analiza
1	Monitorimi i zhurmave	Çdo 6 muaj muaj	Normat e lejuara sipas udhezimit nr.8
2	Monitorim parametrave fiziko – kimike i ujit te perdorur para shkarkimit ne lume	Çdo 6 muaj muaj	Analize e plote. Parametrat fizike, temperatura, pH, lenda pezull, COD, percjellshmeria elektrike Norma e Lejuara do te jene sipas VKM Nr.177
3	Matja - Listimi i te gjitha mbeturinave dhe krahasimi me standartet ISO 1990/2000.	Çdo jave	Peshimi dhe asgjесim/riciklimi i tyre
4	Emetimi dhe depozitimi i pluhurit	Periodik	Ne pika te ndryshme brenda dhe jashte kantierti
5	Analiza e mjediseve ku punohet	Periodik	Lageshti, ajrimi, temperatura, pluherat dhe zhurmat
6	Saisite e karburanteve dhe detergjenteve qe perdoren	Periodik	Nafta, solari detergjentet dhe kimikatet e tjere

Investitori mirepret çdo sugjerim nga AKM-ja dhe ARM-ja ne lidhje me shtimin e elementeve te monitorimit dhe metodikes se perdorur. Per te realizuar matje sa me te sakta subjekti do te konsultohet me specialiste dhe staf akademik i cili do te sugjeroje instrumenta mates te pershtatshme dhe metodike lehtesisht te perdorshme nga personeli per te bere llogaritjet.

Administratore
Merita Sheremadhi

